



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 400 Prot.

Durrës më, 7 / 3 / 2022

V E N D I M

Nr. 13 Datë 7 / 3 2022

PËR

"MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR SI DHE NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL (2 VJEÇAR), NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE PROFESIONAL SI DHE NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË", PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 69 pika 3, si dhe referuar shkresës nr.98/5 datë 08.02.2022 të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, shkresës nr.98/1 datë 25.01.2022 të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, shkresës nr.98/2 datë 27.01.2022 të Fakultetit të Studimeve Profesionale, shkresës nr.98/3 datë 04.02.2022 të Fakultetit të Edukimit, shkresës nr.98/4 datë 04.02.2022 të Fakultetit të Biznesit, lidhur me përcaktimin e kuotave për të tre ciklet e studimit, për vitin akademik 2022 – 2023, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Senati Akademik ,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor si dhe në programet e studimeve me karakter profesional (2 vjeçar), në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave dhe Profesional si dhe në ciklin e tretë të studimeve "Doktoratë", për vitin akademik 2022-2023, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët.
 - Administratori.
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore.
3. Ky vendim i përcillet për miratimin përfundimtar Bordit të Administrimit
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. ~~Kseanela~~ SOTIROFSKI

